



1

**PROTOKOLL**  
**PER BASHKEPUNIMIN NE FUSHEN E DREJTESISË MIDIS**  
**MINISTRISË SE DREJTESISË SE REPUBLIKES SE SHQIPERISË DHE**  
**REPUBLIKES ARABE TE EGJYPTIT**

Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë nga njera anë dhe  
Ministria e drejtësisë e Republikës arabe të Egjiptit nga ana tjetër;

-duke u nisur nga dëshira për të dhënë shtytje të metejshme forcimit të  
lidhjeve tradicionale e miqësore midis dy vendeve dhe popujve;

-duke e parë të domosdoshme vendosjen e lidhjeve të ngushta në fushën e  
drejtësisë si dhe shkëmbimin e përvojës midis juristëve dhe magistratëve të të dy  
vendeve

- duke pasur besim se një bashkëpunim i tillë do të ndihmojë për forcimin  
e legjislativës shtetërore dhe për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të  
njeriut ;

rane dakort të nënshkruajnë këtë protokoll

**NENI 1**

Te dy palet do të informojnë njera tjetrën për veprimtaritë legjislative të  
vendeve të tyre në fushën e drejtësisë.

Te dy palet mund të paraqesin herë pas here problemet që ndeshin në  
praktikën juridike ,te cilat mund të diskutohen në mes ekspertëve egjiptianë dhe shqiptarë.

**NENI 2**

Te dyja palet do të shkëmbejnë përvojën juridike në fushat me interes të  
përbashkët,që do të realizohet përmes takimeve të punës dhe të shkëmbimit të  
vizitave të grupeve të ekspertëve.

### NENI 3

Shkembimi i pervojës do të bëhet nga magistratë dhe juristë. Organizimi i veprimtarive për realizimin e këtij qëllimi do të koordinohet nga departamentet përkatëse të marrëdhënjëve ndërkombëtare të të dy ministrive.

### NENI 4

Me qëllim të pasurimit të njohurive mbi funksionimin e organeve juridike dhe mbi administrimin me të mirë të drejtësisë do të organizohen këtu pas këtu me ekspertet konferenca simpoziume dhe seminare.

### NENI 5

Do të botohen këtu pas këtu në organet e specializuara respektive informacione, studime dhe materiale të tjera mbi veprimtaritë profesionale shkencore në fusha të ndryshme të të drejtave qytetare dhe të administrimit të drejtësisë.

### NENI 6

Pala egjiptiane do të japë mundësi magistratëve, juristëve dhe ekspertëve shqiptarë që të kryejnë specializime në periudha të ndryshme me qëllim të njohjes dhe shfrytëzimit të pervojës Egjiptiane.

### NENI 7

Pala egjiptiane do të shikojë mundësinë për të dhënë palës shqiptare asistencë për literaturë juridike, e cila do të ndihmojë gjatë procesit të zbatimit të reformës legjislativë. Kjo asistencë mund të përfshijë dhe dërgimin e pajisjeve dhe mjeteve të nevojshme për të përmirësuar funksionimin e sistemit gjyqësor në Shqipëri.

NENI 8


Te dy palet rane ne parim dakort per te vendosur lidhjet e bashkepunimit ne fushen penale dhe angazhohen te punojne per arritjen e nje konvente dypaleshe te ndihmes se ndersjellte gjyqsore ne fushat penale, familjare dhe civile.

NENI 9


Ky protokoll hyn ne fuqi menjehere pas nenshkrimit dhe do te jete ne fuqi per nje periudhe prej pese vjetesh nga data e nenshkrimit. Departamenti i Marredhenieve me Jashte i Ministrise se Drejtesise se Republikes se Shqiperise dhe Departamenti i bashkepunimit nderkombetar ne Ministrine e Drejtesise se Republikes Arabe te Egjyptit, ngarkohen me ndjekjen dhe zbatimin praktik te kesaj marreveshje.

Bere ne Kajro, me 15 Dhjetor 1994, ne dy kopje origjinale ne gjuhet Shqip, Arabe dhe Angleze. Te dy tekstet duke patur fuqi te barabarte. Ne rast divergjence ne interpretim, do te merret per baze teksti ne gjuhen Anglisht.

**MINISTRIA E DREJTESISE E  
REPUBLIKES SE SHQIPERISE**

  
**Vladimir Kristo**

**MINISTRIA E DREJTESISE  
E REPUBLIKES ARABE TE EGJYPTIT**

  
**Farouk Seaf El Nasr**